



**POLITIKË REKOMANDUESE  
PËR SHËNDETIN E FËMIJËVE**



**POLITIKË REKOMANDUESE  
PËR SHËNDETIN E FËMIJËVE**

# RRETH KOMF

---

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve është një koalicion i përbërë nga 35 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Në kuadër të KOMF veprojnë katër grupe tematike, të cilat punojnë në sektorët e mbrojtjes, arsimit, shëndetësisë dhe fuqizimit të KOMF.

Një nga këto grupe është Grupi Tematik për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shëndetësi. Ky grup përbëhet nga organizatat anëtare dhe partnerë të jashtëm të KOMF, të cilët marrin pjesë në grup në përputhje me profilin e tyre, ekspertizën, fushën e veprimit dhe atë të interesit.

Kjo politikë rekomanduese u hartua nga Grupit Tematik për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shëndetësi.



# PËRMBAJTJA

**6**

Përmbledhje

**7**

Çështjet prioritare të adresuara në këtë politikë rekomanduese

**8**

Gjdhënia, imunizimi dhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore për fëmijët në kujdesin parësor

**11**

Shërbimet shëndetësore për fëmijët në kujdesin sekondar dhe terciar

**13**

Shërbimet shëndetësore për fëmijët e komuniteteve

**16**

Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi me narkotikë, duhani, alkooli dhe pijet energjike

**19**

Mbrojtja e shëndetit mendor të fëmijëve

**21**

Mbrojtja e fëmijëve nga ndotja e ajrit

**24**

Furnizimi me barna dhe Lista e Barnave Esenciale

**26**

Ligji për Sigurime Shëndetësore

**28**

Integrimi i shërbimeve shëndetësore me shërbimet arsimore dhe sociale

**29**

Blerja e shërbimeve shëndetësore nga sektori jo qeveritar dhe privat

# PËRMBLEDHJE

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, i cili përfaqëson 35 organizata jo qeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, përmes kësaj politike rekomanduese, kërkon vendosjen e shëndetit të fëmijëve në qendër të prioritetëve dhe të veprimeve në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorive Komunale për Shëndetësi.

KOMF vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Shëndetësisë për hartim dhe plotësim – ndryshim të legjislacionit, por konsideron se investimet e ulëta në sektorin e shëndetësisë pengojnë zbatimin e legjislacionit duke rrezikuar shëndetin e fëmijëve.

KOMF po ashtu kupton dhe është i vetëdijshëm për faktin se shëndetësia në Kosovë po përballet me shumë vështirësi, sidomos me gjendjen e krijuar nga Covid-19. Megjithatë duke patur parasysh ndjeshmërinë fizike dhe psikologjike që karakterizon fëmijët si qenie në zhvillim, KOMF kërkon vëmendje dhe ndërhyrje të menjëhershme në çështjet e adresuara në këtë politikë, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve.

KOMF rekomandon fuqishëm Ministrinë e Shëndetësisë dhe Drejtoritë Komunale për Shëndetësi që të rrisin investimet në sektorin e shëndetësisë, me qëllim implementimin dhe zbatimin e reformave dhe politikave në këtë sektor, të cilat ndikojnë në sigurimin e shërbimeve cilësore për fëmijë.

E drejta e fëmijës për trajtim shëndetësor garantohet si me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, ashtu dhe me legjislacionin e Kosovës. Fëmijët kanë të drejtën për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet shëndetësore.

# ÇËSHTJET PRIORITARE

---

- + Gjdhënia, imunizimi dhe shërbimet shëndetësore për fëmijët në kujdesin parësor
- + Shërbimet shëndetësore për fëmijët në kujdesin sekondar dhe terciar
- + Shërbimet shëndetësore për fëmijët e komuniteteve
- + Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi me narkotikë, duhani, alkooli dhe pijet energjike
- + Mbrojtja e shëndetit mendor të fëmijëve
- + Mbrojtja e fëmijëve nga ndotja e ajrit
- + Furnizimi me barna dhe Lista e Barnave Esenciale
- + Ligji për Sigurime Shëndetësore
- + Integrimi i shërbimeve shëndetësore, sociale dhe arsimore
- + Blerja e shërbimeve shëndetësore nga sektori jo qeveritar dhe privat



## Gjidhënia, imunizimi dhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore për fëmijët në kujdesin parësor

Sipas raportit “Treguesit kryesorë të Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë – MICS” të publikuar në Nëntor 2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe zyra e UNICEF në Kosovë, vetëm 32% e të porsalindurve ushqehen me gji brenda orës së parë pas lindjes, ndërsa të ushqyerit vetëm me gji është prevalent vetëm për 29% të fëmijëve nën moshën 6 muajsh, të dhëna këto që shfaqin nivel mjaft të ulët të ushqyerjes me gji.

Bazuar në të dhënat e MICS, 73% e fëmijëve të moshës 24 - 26 muaj në Kosovë kanë marrë të gjitha vaksinat sipas kalendarit të imunizimit. Statusi ekonomik i familjes është i lidhur me vaksinimin e plotë: 4 në 5 fëmijë të moshës 24 - 35 muaj që jetojnë në familjet më të pasura në Kosovë janë plotësisht të vaksinuar, krahasuar me 3 në 5 fëmijë që jetojnë në familjet më të varfra. Të dhënat e organizatave anëtare të KOMF, tregojnë se gjendja me imunizimin e fëmijëve është përkeqësuar edhe më shumë gjatë vitit 2020, kjo për shkak të frikës së prindërve nga infektimi me Covid-19.<sup>1</sup>

Të dhënat nga Raporti MICS tregojnë 3 nga 4 të porsalindur në popullsinë e përgjithshme kanë pasur vizita shëndetësore postnatale te ofruesit e kujdesit shëndetësor brenda javës së parë pas lirimt nga institucioni shëndetësor, përderisa 1 nga 3 kanë pasur vizita shëndetësore postnatale pas javës së parë pas lirimt. 6% e të porsalindurve nuk kanë pasur vizita shëndetësore postnatale pas lirimt nga spitali, përderisa përqindja e nënave që nuk kanë pasur vizita shëndetësore ishte më e lartë me 39%.<sup>2</sup>

Në disa prej Qendrave të Mjekësisë Familjare në disa komuna ka mungesë të gjinekologëve dhe pediatërve, kjo për shkak të shuarjes së pozitive të specializuara në kujdesin parësor. Në raste të tilla pacientët kanë problem të shkojnë në komuna të mëdha për të marrë shërbimet gjinekologjike. Kjo sidomos është problematikë në zonat më të thella, siç është Komuna e Dragashit që aktualisht nuk ka gjinekolog dhe pacientet kanë problem të shkojnë për kontrolle shëndetësore në Komunën e Prizrenit.

<sup>1</sup> Të dhëna nga Balkan Sunflowers Kosova

<sup>2</sup> Treguesit kryesorë të Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë – MICS” të publikuar në Nëntor 2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe zyra e UNICEF në Kosovë.






Gjithashtu, prioritet dhe rëndësi të veçantë gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore duhet t'i kushtohet fëmijëve të cenueshëm si fëmijëve pa kujdes prindëror, viktimat të dhunës në familje, viktimat të abuzimit, fëmijëve në situatë rruge, fëmijëve viktimat të trafikimit dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Sipas informacioneve të organizatave anëtarëve të KOMF, këta fëmijë jo gjithmonë kanë prioritet dhe marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore.

## REKOMANDIME:

- +** Investimi në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët në kujdesin parësor, rritja e imunizimit dhe gjidhënies, duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve.
- +** Intensifikimi i programit të vizitave në shtëpi nga Qendrat e Mjekësisë Familjare në të gjitha komunat e Kosovës, për të mundësuar vaksinimin në shtëpi (vaksinimin derë më derë), mbështetjen e praktikave të gjidhënies, të ushqyerit e shëndetshëm si dhe identifikimin e problemeve shëndetësore tek fëmijët, duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve.
- +** Shtrirja e programit të vizitave në shtëpi nga Qendrat e Mjekësisë Familjare në komunat ku programi nuk funksionon aktualisht. Programi i vizitave në shtëpi aktualisht operon në 22 komuna të Kosovës.<sup>4</sup>
- +** Zgjerimi dhe promovimi i modelit të Qendrave Informuese për Shëndetin e Gruas (QIShG – Klasat për nëna) për të promovuar edukimin shëndetësor, shëndetin e nënave gjatë shtatzënisë, gjidhënien, vaksinimin dhe rritjen e shëndetshme. Aktualisht programi i QIShG funksionon në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike në Prishtinë dhe në QMF dhe QKMF në 12 komuna.<sup>5</sup>
- +** Ofrimi i shërbimeve gjinekologjike të paktën një herë në javë tek komunat e zonave më të thella për pacientet në qendrat e kujdesit parësor. Për shembull, gjinekologu nga Komuna e Prizrenit, një herë në javë të vizitojë Qendrën e Mjekësisë Familjare në Dragash për të ofruar shërbime për gratë paciente.

<sup>4</sup> Komunat me shumicë shqiptare ku programi implementohet aktualisht janë: Mitrovicë, Gjakovë, Dragash, Gjiilan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Prizren, Shtime, Kaçanik, Viti, Kamenicë, Han i Elezit, Vushtrri, Drenas, Skenderaj, Istog, Pejë, Junik, Klinë dhe Deçan.

<sup>5</sup> Ferizaj, Mitrovicë, Kaçanik, Klinë, Prizren, Dajkovc, Pejë, Obiliq, Gjiilan, Kamenicë, Hani i Elezit dhe Lipjan.



- + Ministria e Shëndetësisë duhet të propozojë ndryshimet ligjore drejt Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, duke paraparë masa ndëshkuese për prindërit të cilët neglizhojnë dhe refuzojnë vaksinimin e fëmijëve. Modele të tilla mund të merren nga shtete të Europës, ku mos-vaksinimi i fëmijëve nga prindërit cilësohet si neglizhim shëndetësor dhe dënohet me gjobë. Gjithashtu, rekomandohet vendosja e vaksinimit të fëmijëve si kusht për regjistrim në shkollë dhe si kriter në kuadër të Ligjit të ri 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale, i cili është në proces të plotësim-ndryshimit.
  
- + Ofrimi i shërbimeve shëndetësore me prioritet për fëmijët pa kujdes prindëror, viktima të dhunës në familje, viktima të abuzimit, fëmijëve në situatë rruge, fëmijëve viktima të trafikimit dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara.



## Shërbimet shëndetësore për fëmijët në kujdesin sekondar dhe terciar


Në Kosovë nuk bëhet “screening test” te të posalindurit në institucionet publike shëndetësore. Ky test diagnostikon një sërë sëmundjesh menjëherë pas lindjes së foshnjës që mundëson trajtimin e sëmundjeve me kohë.

Problematikë në kujdesin sekondar dhe terciar mbetet mbingarkesa e punës në klinikat e pediatriisë. Klinika e Pediatriisë në Qendrën Klinike Universitare në Kosovë në vazhdimësi është e mbingarkuar dhe punon me kapacitete të kufizuara. Sipas raportit të Klinikës së Pediatriisë, vetëm gjatë një jave në muajin Gusht 2021, Klinika ka trajtuar 1,163 fëmijë. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, 785 kanë qenë vizita më kuadër të Emergjencës Pediatrike, kurse 378 vizita në ambulancat specialistike. Brenda javës për trajtim spitalor janë pranuar 206 fëmijë<sup>6</sup>. Bazuar në komunikimet me prindër dhe organizatat anëtare të KOMF, në këtë klinikë ka raste që dy fëmijë trajtohen në një shtrat për shkak të mungesës së hapësirës dhe kushteve.

Përveç kësaj, në këtë klinikë ka numër të vogël të personelit shëndetësor në raport me numrin e pacientëve fëmijë. Për shkak të kufizimeve në burime njerëzore, personeli shëndetësor është tejet i ngarkuar në ofrim të shërbimeve shëndetësore për pacientët fëmijë. Kjo bën që cilësia e shërbimeve shëndetësore për fëmijët të ulet.

Funksionalizimi i plotë i spitalit të ri kirurgjik-pediatrik i cili u hap në muajin Gusht 2021 pritet të përmirësojë përkujdesin shëndetësor të fëmijëve në Kosovë. Spitali pritet të integrojë shërbimet e emergjencave pediatrike mjekësore, ato të traumës, shërbimet e rikuperimit, ambulancave specialistike, pediatrike dhe kirurgjike, sallat e operacioneve urgjente e të tjerë. Megjithatë duke parë mbingarkesën dhe numrin e vogël të stafit, rritja e burimeve njerëzore dhe riorganizimi i punës është i domosdoshëm.


<sup>6</sup> <https://shskuk.rks-gov.net/News/SingleNews/7923>



---

**REKOMANDIME:**

- +** Realizimi i “screening test” te të posalindurit në institucionet publike dhe private shëndetësore për diagnostikim të sëmundjeve potenciale.
- +** Rritja e numrit të personelit shëndetësor në Klinikën e Pediatriisë me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore për fëmijët.
- +** Funkcionalizimi i plotë i Spitalit të ri kirurgjik – pediatrik në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.



## Shërbimet shëndetësore për fëmijët e komuniteteve

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian kanë sfida të shumta në marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, sikurse: varfëria, blerja e barnave, diskriminimi, mungesa e dokumenteve të identifikimit, mungesa e informacionit dhe edukimit shëndetësor etj.

Sipas raportit MICS, vlerësohet se 16 fëmijë nën moshën 5 vjeçare vdesin për çdo 1000 lindje të gjalla. Kjo shifër është pothuajse dy herë më e lartë në mesin e fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me 27 fëmijë që vdesin për çdo 1000 lindje të gjalla.

Sa i përket shëndetit të nënës, edhe pse pothuajse të gjitha gratë në popullsinë e përgjithshme janë kontrolluar katër herë apo më shumë para lindjes nga cilido ofrues i kujdesit shëndetësor, kjo ka ndodhur vetëm për 3 nga 4 gra që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Boshllëku ka qenë më i madh për gratë e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian që jetojnë në zona rurale.

Sipas Raportit të organizatës Balkan Sunflowers Kosova, mbi gjendjen shëndetësore të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës, Shtimes, Obiliqit dhe Graçanicës, 16 % të të porsalindurve dhe 63% të nënave nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian nuk kanë pasur vizita shëndetësore postnatale pas lirimt nga spitali. Sipas këtij raporti, 60.94% e grave në Fushë Kosovë dhe 71.15% në Obiliq, nuk e vizitonin rregullisht gjinekologun. Bazuar në të dhënat e këtij raporti, mbi 50% e të anketuarve, janë përgjigjur që nuk ju nevojitet gjinekologu.

Shkalla e natalitetit në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian mbetet e lartë nga viti në vit. Janë 43 (7.5%) gra shtatëzëna nga 574 familje të anketuara në katër komuna. Nga ky numër, 15 nga to janë nën moshën 18 vjeçare.<sup>7</sup>

<sup>7</sup> Raport mbi gjendjen shëndetësore të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës, Shtimes, Obiliqit dhe Graçanicës, Balkan Sunflowers Kosova, [http://www.balkanSunflowers.org/site/assets/files/1154/raporti\\_shqip\\_final.pdf](http://www.balkanSunflowers.org/site/assets/files/1154/raporti_shqip_final.pdf)



Vetëm 38% e fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë vaksinuar plotësisht. Krahasuar me 73% e fëmijëve në popullatën e përgjithshme që kanë marrë të gjitha vaksinat sipas kalendarit për imunizim, përqindja e ulët prej 38% e vaksinimit të fëmijëve nga komunitet është tejet shqetësuese.<sup>8</sup> Sipas një monitorimi të bërë gjatë vitit 2020 në 12 komuna të Kosovës<sup>9</sup> nga organizata anëtare e KOMF, Balkan Sunflowers Kosova, vetëm 41% e fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ishin vaksinuar.

Komunitetet Rom dhe Ashkali vuajnë nga një prevalencë e lartë e të ushqyerit joadekuat dhe të pamjaftueshëm, gjë që kontribuon në shëndetin e dobët dhe jetëgjatësinë të shkurtër. Në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, çdo i 7-ti fëmijë nën 5 vjeç ka ngecje në rritje. 1 në 14 fëmijë nën 5 vjeç që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë nën peshë. Dukuria e nënpeshës zvogëlohet me pasurinë e ekonomisë familjare dhe nivelin e arsimimit të nënës. Përderisa 8% e fëmijëve të moshës 2–17 vjeçare në popullsinë e përgjithshme u raportua se kishin vështirësi funksionale në të paktën një fushë, një përqindje më e lartë u raportua në mesin e fëmijëve të kësaj moshe që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, përkatësisht 14%.<sup>10</sup>

Bazuar në të dhënat e mësipërme, konstatohet se sa i përket përkujdesjes shëndetësore ka **diskrepancë të madhe** në mes të fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijëve nga popullsia e përgjithshme. Ministria e Shëndetësisë duhet të rishikojë strategjitë për përfshirjen e komuniteteve, me fokus tek shëndeti i nënave dhe fëmijëve (p.sh. vizitat neonatale të shtatzënave, imunizimi tek fëmijët, ushqyerja e shëndetshme, kontrollet postnatale etj.).

<sup>8</sup> Treguesit kryesorë të Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë – MICS” të publikuar në Nëntor 2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe zyra e UNICEF në Kosovë.

<sup>9</sup> Mitrovicë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Gjilan, Klinë, Istog, Pejë, Prizren.

<sup>10</sup> Treguesit kryesorë të Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë – MICS” të publikuar në Nëntor 2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe zyra e UNICEF në Kosovë.



## REKOMANDIME:

- +** Prioritizimi i shëndetit të nënave dhe fëmijëve në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Nacional dhe poashtu në planet lokale të veprimit në komunat ku jetojnë komunitetet.
- +** Sigurimi i kujdesit parësor shëndetësor për nënat dhe fëmijëve para, gjatë dhe pas lindjes.
- +** Rritja e numrit të vizitave shtëpiake për të mundësuar vaksinimin derë më derë, mbështetjen e të ushqyerit të shëndetshëm dhe identifikimin e fëmijëve me vështirësi funksionale.
- +** Ministria e Shëndetësisë dhe komunat të parashohin indikatorë dhe ndajnë buxhet specifik në kuadër të formulës së financimit për shëndetësi për të trajtuar çështjet shëndetësore në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- +** Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi shëndetësor përmes fushatave për përmirësimin e praktikave shëndetësore, planifikim familjar, shëndetin riprodhues dhe marrjen e shërbimeve shëndetësore.
- +** Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimit të shërbimeve të ofruara për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.



## Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi me narkotikë, duhani, alkooli dhe pijet energjike

Në bazë të instrumentit monitorues ndërkombëtar “Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës”, Kosova ka shënuar një rezultat shumë të ulët prej 0,396 nga rezultati i mundshëm prej 1.0 në parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve viktime të abuzimit me narkotikë.

Kosova nuk ofron shërbime të veçanta të rehabilitimit për fëmijët viktime të abuzimit me narkotikë; këto shërbime ofrohen në kuadër të shërbimeve të përgjithshme të trajtimit të të rriturve që përdorin narkotikë. Klinika Psikiatrike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka improvizuar një repart të posaçëm për trajtimin e varësisë por ky repart është i dedikuar për pacientët e rritur, edhe pse ai trajton edhe fëmijët duke qenë se nuk ekziston asnjë objekt tjetër në dispozicion ose repart i veçantë për fëmijët. Kjo njësi nuk është e përshtatshme për fëmijët dhe nuk është mjedis miqësor dhe i sigurtë për ta.

Trajtimi shëndetësor në QKUK bazohet vetëm në programet e detoksikimit ku përdoren barna nga Lista e Barnave Esenciale. Edhe pse bazuar në këtë listë kujdesi shëndetësor dhe trajtimi me barna (p.sh. detoksikimi) ofrohet falas, në praktikë pacientët fëmijë dhe të moshuar trajtohen pa pagesë, përderisa të rriturit duhet të paguajnë në shumën prej 5 euro në ditë për qëndrim deri në dy javë.

Psikiatrit dhe mjekët pediatër në spitale, nuk kanë kapacitete adekuate për të trajtuar fëmijët që janë viktime të abuzimit me narkotikë dhe nuk kanë burimet e nevojshme (ekipin multidisiplinar, repartet ose klinikat e ndara) për zbatimin e planeve dhe programeve përkatëse për rehabilitim. Për shkak të mungesës së burimeve të nevojshme, ata nuk mund të mbështesin prindërit ose kujdestarët për t'u marrë me fëmijët viktime të abuzimit me narkotikë. Si përfundim, në thelb nuk ka shërbime të veçanta për identifikimin, rehabilitimin fizik, psikologjik dhe reintegrimin social që mbështesin fëmijët që janë viktime të abuzimit me narkotikë. Poashtu ka mungesë të shërbimeve mobile në komunitet të cilat do të mundësonin testimin dhe identifikimin e rasteve.





OJQ Labyrinth është e vetmja OJQ lokale e licencuar nga MSH për të trajtuar personat me varësi nga drogat. Shërbimet e ofruara nga kjo OJQ nuk sponsorizohen nga shteti dhe OJQ Labyrinth nuk është në gjendje të mbulojë të gjitha nevojat.

Mangësi tjetër e sistemit që kontribuon në llogaridhënie të ulët ka të bëjë me mungesën e të dhënave të centralizuara dhe mungesën e një baze të të dhënave në nivel nacional mbi raportimet e rasteve të fëmijëve viktime të abuzimit me narkotikë.

Fëmijët në Kosovë janë të ekspozuar dhe të rrezikuar edhe nga pirja e duhanit, qoftë ajo aktive apo pasive. Fëmijët e ekspozuar ndaj pirjes pasive të duhanit në familje apo ambiente të tjera të mbyllura kanë një rrezik më të madh të marrjes së infeksioneve dhe sëmundjeve të mushkërive, duke përfshirë bronkitin, pneumoninë si dhe sëmundjet kardiovaskulare. Edhe pse në vitin 2008 Kosova ka miratuar Ligjin për Kontrollin e Duhanit, qytetarët e Kosovës në masë të madhe e shkelin këtë Ligj. Ligji i duhanit nuk respektohet në shumë prej lokaleve afariste, duke përfshirë këtu edhe lokalet ushqimore në afërsi të shkollave të cilat frekuentohen në vazhdimësi nga fëmijët.

Një shqetësim tjetër për shëndetin e fëmijëve në Kosovë, përbën edhe konsumimi i pijeve energjike. Pijet energjike në tregun në Kosovë janë nga më të ndryshmet dhe i shiten çdokujt pavarësisht moshës. Pijet energjike përmbajnë kafeinë dhe stimulues të zemrës, që jo vetëm nuk janë të nevojshme për fëmijët, por përkundrazi, janë të dëmshme, mund të çrregullojnë ritmin e zemrës, si dhe të ndikojnë në shkaktimin e problemeve të tjera shëndetësore. Kosova është njëra ndër vendet e cila ende nuk ka ndonjë bazë ligjore për ndalimin, sanksionimin e shitjes dhe përdorimit të pijeve energjike tek fëmijët.

Poashtu, shqetësues mbetet rregullimi ligjor në kuadër të Kodit Penal të Kosovës i cili ndëshkon shitjen dhe shërbimin e pijeve alkoolike për personat nën moshën 16 vjet, përderisa sipas legjislacionit në Kosovë fëmijë konsiderohen personat deri në moshën 18 vjet.



## REKOMANDIME:

- +** Ministria e Shëndetësisë rekomandohet të vendosë si prioritet mbrojtjen e fëmijëve viktima të abuzimit me narkotikë nëpërmjet fuqizimit të shërbimeve të rehabilitimit në kuadër të QKUK dhe spitaleve rajonale si dhe zhvillimit të skemës së qëndrueshme të financimit dhe blerjes së shërbimeve të ofruara nga organizatat jo qeveritare për ofrimin e shërbimeve për fëmijët viktima të abuzimit me narkotikë në komuna në mënyrë që këto shërbime të jenë më të qasshme dhe më afër për personat në nevojë.
- +** Fuqizimi i shërbimeve të trajtimit dhe rehabilitimit në kuadër të QKUK përmes krijimit të një njësie të veçantë vetëm për fëmijë. Kjo njësi duhet të ofrojë ambient miqësor dhe të sigurtë për trajtimin e fëmijëve viktima të abuzimit me narkotikë.
- +** Zhvillimi i masave dhe programeve për parandalimin e përdorimit të drogave dhe duhanit nga fëmijët. Organizimi i ekipeve mobile në komunitet për identifikim, testim dhe mbështetje të rasteve të fëmijëve viktima të abuzimit me narkotikë.
- +** Ofrimi i shërbimeve profesionale të trajtimit dhe rehabilitimit të miturve, përdorues të drogave në qendrën edukuese korrektuese për të mitur.
- +** Ministria e Shëndetësisë duhet të krijojë mekanizma të qëndrueshëm për mbledhjen e të dhënave në nivel komunal dhe qendror në mënyrë që të gjenerojë të dhëna të sakta dhe të qëndrueshme për numrin e fëmijëve viktima të abuzimit me narkotikë, moshën, statusin ekonomik, llojet e drogave etj. Këto dhëna do të ndihmonin në një planifikim më adekuat të programeve dhe shërbimeve përkatëse.
- +** Rritja e monitorimit dhe inspektimit të pirjes së duhanit në të gjitha ambientet e ndaluara me ligj.
- +** Zhvillimi apo sponsorizimi i fushatave vetëdijesuese për ndërgjegjësimin e masës për dëmet që shkakton konsumimi i drogave, pirja e duhanit, sidomos tek fëmijët.
- +** Rregullimi i kornizës ligjore që ndalon shitjen dhe konsumimin e alkoolit dhe pijeve energjike për personat nën moshën 18 vjeç.



## Mbrojtja e shëndetit mendor të fëmijëve

Pandemia globale Covid-19, prej më shumë se një viti ka shkaktuar një paralizë të shumë sferave të jetës, me ndryshime radikale e të menjëhershme në mënyrën e jetesës tonë. Kjo situatë e jashtëzakonshme, shoqëruar me pasigurinë totale për të nesërmen, privimin e pjesshëm të lirisë, ndarjen nga njerëzit e dashur dhe ndërprerjen e detyruar të aktiviteteve të përditshme, ka prodhuar shqetësim, ankth e traumë tek çdo individ, mbi të gjitha tek fëmijët.

Ndërprerja e mësimi ishte një ndër faktorët kryesor të cilët shkaktuan kaos në jetët e fëmijëve e ndër të tjera ngjallën frikë e pasiguri mes tyre. Ndërprerja e mësimi në Mars 2020, ishte e detyrueshme dhe e përshpejtuar si pasojë e shpërthimit të pandemisë, duke mos lënë asnjë hapësirë për ta bërë procesin më gradual e të pranueshëm për fëmijët.

Bazuar në të dhënat e MICS, tek fusha “Funksionimi i fëmijëve”, ankthi u raportua si sfera kryesore e vështirësisë funksionale tek fëmijët e moshës 5–17 vjeçare: 5% ndërmjet fëmijëve në popullatën e përgjithshme dhe 6% ndërmjet fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Vlen të përmendet që të dhënat e mësipërme tregojnë gjendjen para pandemisë, përderisa nuk ka të dhëna dhe hulumtime për shëndetin mendor të fëmijëve gjatë pandemisë.

Shëndeti mendor është një nga objektivet në kuadër të Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Shëndetësisë. Poashtu, Qeveria në Dhjetor 2020 ka miratuar Planin e Veprimit për Shëndetin Mendor përgjatë pandemisë Covid– 19. Ky Plan i Veprimit ende nuk ka gjetur zbatim në praktikë.



**REKOMANDIME:**

- +** Mbështetja me burime shtesë e Qendrës për Fëmijë dhe Adoleshentë në kuadër të Klinikës së Psikiatrisë në SHSKUK dhe strukturave ekzistuese të shtatë Qendrave regjionale të shëndetit mendor për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve që kanë nevojë për shërbime të specializuara të shëndetit mendor.
- +** Integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor në shkolla përmes angazhimi të stafit profesional, sikurse angazhimi i psikologëve. Integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor me shërbime sociale në menaxhimin e rasteve.
- +** Vetëdijesimi dhe avokimi drejt familjeve me qëllim zvogëlimin e stigmës dhe promovimin e kujdesit dhe mbrojtjes së shëndetit mendor të fëmijëve.
- +** Hulumtim mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në shëndetin mendor të fëmijëve, me qëllim të planifikimit të ofrimit të shërbimeve.



## Mbrojtja e fëmijëve nga ndotja e ajrit

Viteve të fundit qytetarët e Kosovës po përballen me problemin e ndotjes së ajrit, sidomos në zonat urbane. Fëmijët janë pjesa më e atakuar nga dëmet shëndetësore fizike dhe psikologjike që shkakton ndotja e ajrit. Sipas matjes së ndotjes së ajrit në Kosovë, të bërë nga Ambasada e SHBA-së, në vitet e fundit gjendja ka qenë alarmuese, ku indeksi ka shënuar një vlerë më të lartë se 500 µg/m<sup>3</sup>, e cila konsiderohet si vlerë shqetësuese sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë.<sup>11</sup>

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, është vlerësuar që ndotja e ajrit në Kosovë shkakton 852 vdekje të parakohshme, 318 raste të reja të bronkitit kronik, 605 raste të pranuar në spital dhe 11,900 vizita emergjente në çdo vit.


Studimet e fundit tregojnë se personat që kanë qenë më të ekspozuar gjatë fëmijërisë së tyre në ajër të ndotur kanë prirje për të pasur ngecje në zhvillim fizik dhe psikologjik gjatë jetës së tyre. Konkretisht, ekspozimi në ajër të ndotur ndikon në mënyrë negative në zhvillimin e trurit të fëmijës, kujtesën, bashkëveprimet sociale dhe përvetësimin e shkathtësive në përgjithësi. Kjo automatikisht vë në disavantazh fëmijët që rriten në mjedise të tilla. Përveç fëmijëve, ndotja e ajrit mund të shkaktojë dëme të mëdha edhe tek gratë shtatzëna. Ekspozimi i nënës ndaj ndotjes së ajrit mund të shkaktojë abort, lindje të parakohshme, peshë të ulët të fëmijës së sapolindur etj.<sup>12</sup>

Sipas Strategjisë së Cilësisë së Ajrit 2013-2021, e aprovuar në vitin 2013 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndotës kryesor të ajrit në Kosovë janë: Termocentralet, mihjet, komplekset industriale, sistemet për ngrohje qendrore, prodhimi i bazës së asfaltit, transporti, bujqësia, etj. Gjithsesi, nga faktorët e identifikuar konsiderohet se shkaktarët më të mëdhenj janë mënyra e ngrohjes, prodhimi i energjisë dhe lirimi i gazrave nga mjetet e transportit.<sup>13</sup>

<sup>11</sup> Instituti GAP "Shkaqet e ndotjes së ajrit në Prishtinë, [https://www.institutigap.org/documents/69660\\_ShkaqeteNdotjesseAjritnePrishtine.pdf](https://www.institutigap.org/documents/69660_ShkaqeteNdotjesseAjritnePrishtine.pdf)

<sup>12</sup> Impact of Air Pollution on health and measures to reduce exposures in Kosovo, UNICEF.

<sup>13</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia për cilësinë e ajrit, 2013 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\\_per\\_cilesine\\_e\\_Ajrit\\_\\_23\\_\\_Dhjetor\\_2013\\_shqip\[1\]F.PDF](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_cilesine_e_Ajrit__23__Dhjetor_2013_shqip[1]F.PDF)




Përveç kësaj, ajri i ndotur në ambiente të jashtme, nuk mbetet i vetmi shqetësim. Ambientet e brendshme të shkollave nuk plotësojnë standardet për ventilim të ajrit. Në komunat ku ndërtohen shkollat e reja, duhet të merret parasysh ventilimi dhe jonizimi i ajrit brenda në mënyrë që fëmijët të mbrohen nga ndotja e ajrit. Në një planifikim afatmesëm, Ministria e Shëndetësisë dhe ministritë e tjera përkatëse duhet të parashohin pastrimin e ajrit brenda shkollave përmes sigurimit të pajisjeve për pastrim të ajrit, sidomos gjatë muajve të dimrit.


Shteti i Kosovës nuk ka zhvilluar ndonjë hap për të përmirësuar teknologjinë për përmirësimin e ajrit në Kosovë. Madje, nuk ka ndonjë fushatë vetëdijësimi se si teknologjia mund të kontribuojë në mbrojtjen e ajrit dhe shëndetit njëkohësisht, ndërkohë që investimi i Qeverisë në këtë segment është i fundit në vijat buxhetore. Në Kosovë mungon informimi dhe vetëdijësimi i publikut për sëmundjet e shkaktuara nga ndotja e ajrit, parandalimin dhe trajtimin e tyre. I vetmi institucion në vend që ka bërë thirrje në mënyrë periodike për vetëdijësimin e qytetarëve në mbrojtjen e ambientit është Instituti i Shëndetësisë Publike.

## REKOMANDIME:

- + Të zhvillohen hulumtime të bazuara në të dhëna lidhur me ndikimin e ajrit të ndotur në shëndet, me fokus fëmijët. Të bëhen hulumtime të vendeve me problematikë të njëjtë dhe përshtatje të modeleve efektive sipas kontekstit.
- + Ministria e Shëndetësisë të ndajë buxhet për programet që kanë për qëllim parandalimin e ndotjes së ajrit në Kosovë dhe mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve nga ndotja e ajrit.
- + Sigurimi i të dhënave të sakta mbi ndotësit kryesorë të ajrit në Kosovë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe në bazë të të gjeturave, zhvillimi i një plani të veprimit për të planifikuar përmirësimin e ajrit në Kosovë.



- +** Zhvillimi i fushatave të vetëdijesimit mbi dëmet që shkakton ndotja e ajrit, sidomos tek fëmijët si dhe masat për mbrojtjen e shëndetit nga ajri i ndotur. Zhvillimi i fushatave të vetëdijesimit mbi ndalimin e përdorimit të thëngjillit si burim për ngrohje gjatë dimrit. Zhvillimi i fushatave të vetëdijesimit në shkolla për fëmijët me qëllim të edukimit të tyre mbi ruajtjen e ambientit.
- +** Sigurimi i pajisjeve për jonizim dhe ventilimi të ajrit në shkolla.



## Furnizimi me barna dhe Lista e Barnave Esenciale

Në vazhdimësi raportohet për mungesë të barnave, infuzioneve dhe materialeve të tjera në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – QKUK, spitalet rajonale dhe në kujdesin parësor. Mungesa e terapisë së nevojshme për fëmijët në nevojë për terapinë përkatëse, mund të sjellë pasoja fatale për fëmijët dhe shëndetin e tyre. Sa i përket mungesës së barnave, jo rrallë herë pacientët detyrohen t'i blejnë vetë edhe materialet më esenciale, duke filluar prej epruvetave për testimin e gjakut, fashot e deri tek tretjet fiziologjike.

Krahas materialeve shpenzuese bazike, jashtëzakonisht shqetësuese mbetet edhe mungesa e barnave nga lista esenciale pa të cilat fëmijët nuk mund të mbijetojnë. Këtu hyn insulina e cila edhe pse figuron si bar në listën e barnave esenciale, herë pas here ka mungesë në praktikë. Në këto raste, jo të gjitha familjet kanë mundësi të blejnë insulinën për shkak të gjendjes së rënduar financiare.

Edhe me medikamentin surfakant pa të cilin foshnjat e lindura para kohe mund të vdesin, ka probleme të herë pas hershme sa i përket furnizimit të rregullt. Prej vitesh tashmë, medikamentin surfakant e siguron organizata anëtare e KOMF, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë për Klinikën e Neonatologjisë. Mirëpo, në raste të caktuara ka periudha që mbesin të pambuluara me furnizim me këtë medikament dhe si pasojë Klinika e Neonatologjisë mbetet pa të, duke rrezikuar seriozisht jetët e foshnjave të lindura para kohe. Medikamenti surfakant nuk është në kuadër të Listës së Barnave Esenciale. KOMF propozon që edhe medikamentet që sigurohen nga donatorët, të përfshihen në një përqindje të caktuar në kuadër të Listës së Barnave Esenciale, në mënyrë që mos të ketë mungesa. Për shembull, në rastin e barit surfakant, 90% të sigurohet nga donatorët dhe 10% të sigurohet përmes Listës së Barnave Esenciale.

Poashtu, mbetet problematik mos-furnizimi me terapi nga Lista e Barnave Esenciale për fëmijët me fibrozë cistike, e cila hyn tek sëmundjet e rralla.





**REKOMANDIME:**

- +** Ministria e Shëndetësisë duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për sigurimin e qëndrueshëm të barnave në QKUK dhe spitalet rajonale, për të garantuar që barnat esenciale të mos mungojnë asnjëherë. Mungesa e barnave të nevojshme për fëmijët mund të sjellë pasoja të mëdha për shëndetin e tyre, të cilat mund të jenë dhe vdekjeprurëse.
- +** Të sigurohet insulina si bar esencial, në çdo kohë, për të gjithë fëmijët me diabet.
- +** Rishikimi i Listës së Barnave Esenciale, për të përfshirë surfakantin dhe medikamentet për trajtimin e sëmundjeve të rralla.



## Ligji për Sigurime Shëndetësore

Investimet në sektorin e shëndetësisë në Kosovë janë jashtëzakonisht të ulëta, madje më të ulëtat në rajon. Konsiderohet se 86% e pacientëve paguajnë për barna, 59,5% për bashkëpagesa, 33,4% për materiale mjekësore, 31,9% për konsultime (duke përfshirë edhe sektorin privat), 17,3% për çështje të tjera dhe 10% për ushqim. Gjithsej, 88.4% e të gjithë pacientëve të cilët kërkojnë kujdes në institucione shëndetësore kanë paguar nga xhepi.<sup>14</sup> Një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk kanë qasje të mjaftueshme në kujdesin shëndetësor për shkak të pagesave të larta për ilaçe, nga xhepi i tyre. Kjo është akoma më problematike, duke patur parasysh që 22% e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri, përdherisa 7% prej tyre, jetojnë në varfëri ekstreme.<sup>15</sup>

Edhe pse Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurime Shëndetësore është miratuar në vitin 2014, ky Ligj asnjëherë nuk ka hyrë në fuqi. Në Planin Legjislativ të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës për vitin 2021, është paraparë që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurime Shëndetësore, të bëhet deri më 30 Nëntor 2021. Kjo nuk ka ndodhur dhe ky Projektligj është shtyer për vitin 2022. Ligji për Sigurime Shëndetësore në fuqi parasheh që ndër personat e liruar nga pagesa e premiumit dhe bashkëfinancimi të jenë edhe familjet që jetojnë në varfëri, fëmijët në kujdes institucional (fëmijët në kujdestari), fëmijët viktimat të dhunës dhe trafikimit.

Duke patur parasysh ndikimin që do ketë tek sidomos tek fëmijët e cenueshëm hyrja në fuqi e Ligjit për Sigurime Shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë duhet që sa më parë të procedojë për miratim Ligjin për Sigurime Shëndetësore.

<sup>14</sup> Publikim "A po realizohet e drejta ime për shëndetin më të mirë?", KOMF, 2017

<sup>15</sup> Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Shëndetësisë 2017 – 2021



**REKOMANDIME:**

- +** Miratimi dhe hyrja në fuqi sa më parë e Ligjit Nr. 04/L-249 për Shërbime Shëndetësore.
- +** Të sigurohet që edhe Ligji i ri për Sigurime Shëndetësore të parashohë që ndër personat e liruar nga pagesa e premiumit dhe bashkëfinancimi të jenë edhe familjet që jetojnë në varfëri, fëmijët në kujdes institucional (fëmijët në kujdestari) dhe fëmijët tjerë të cenueshëm sikurse fëmijët viktima të dhunës, trafikimit etj.
- +** Të parashihen incentivat në bazë të performancës për institucionet shëndetësore. P.sh. ato institucione shëndetësore që tregojnë rezultate më të mira në lidhje me shëndetin e nënave dhe fëmijëve, të pranojnë më shumë buxhet në formë te incentives. Kjo menyrë është treguar e suksesshme në vende të ndryshme dhe ka ndikuar në rritjen e cilësisë në institucionet shëndetësore.




## Integrimi i shërbimeve shëndetësore me shërbimet arsimore dhe sociale

Sipas raporteve dhe studimeve në Kosovë, shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve nuk janë të integruara mes sektorëve që prekin të drejtat e fëmijëve. Këtu hyjnë shërbimet shëndetësore, sociale dhe arsimore. Për integrimin e shërbimeve shëndetësore me shërbimet arsimore dhe sociale, ofrohen dy alternativa. Alternativa e parë është përmes punësimit apo kontraktimit të profesionistëve shëndetësor në kuadër të institucioneve arsimore dhe sociale. Alternativa e dytë, e cila ka kosto më të ulët është ofrimi i shërbimeve shëndetësore në institucionet arsimore dhe sociale nga personeli shëndetësor ekzistues, përmes vizitave shëndetësore në shkolla.

Përmes integrimit të shërbimeve, fëmijëve do tu mundësohej marrja e shërbimeve shëndetësore, skringu për shëndetin e tyre si dhe edukimi shëndetësor. Një model i tillë është skringu i shëndetit të fëmijëve përmes vizitave shëndetësore në institucione parashkollore, në shkollë, në institucione të kujdesit social si dhe përmes vizitave në shtëpi.

### REKOMANDIME:

- +** Ministria e Shëndetësisë rekomandohet të integrojë shërbimet shëndetësore me shërbimet arsimore dhe sociale. Integrimi i shërbimeve duhet të fuqizohet përmes bazës ligjore në Ligjin nr. 06/L-084 për Shëndetësi, duke pasuar edhe në akte nënligjore, krijimit të protokolleve integruese për referim dhe trajtim të rasteve.
- +** Zhvillimi dhe rritja e praktikave të integrimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet arsimore dhe sociale. Një model i rekomanduar është realizimi i vizitave të personelit shëndetësor në institucionet arsimore dhe institucionet e kujdesit social për të bërë skringun e shëndetit të fëmijëve.



## Blerja e shërbimeve shëndetësore nga sektori jo qeveritar dhe privat

Aktualisht, Ministria e Shëndetësisë dhe komunat nuk kanë zhvilluar një skemë të qëndrueshme për blerjen e shërbimeve nga sektori jo-qeveritar dhe privat. Mbështetja nga MSH dhe komunat bëhet përmes subvencionimit, e cila nuk konsiderohet si formë e përshtatshme dhe e qëndrueshme për financimin e shërbimeve dhe programeve.

Ministria e Shëndetësisë thirrjen e fundit publike për subvencionimin e projekteve të OJQ-ve në fushën e promovimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës, e kishte shpallur në vitin 2019. Shuma maksimale e mbështetjes financiare për një projekt ishte 15,000 Euro, ndërsa periudha e zbatimit të projektit ishte maksimumi 12 muaj. Ndërkaq, sa i përket vitit 2020 dhe 2021, MSH nuk ka shpallur thirrje për mbështetjen e projekteve të OJQ-ve.

Shuma e ndarë për projektet e OJQ-ve konsiderohet e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e përfituesve dhe nevojat për zbatim të programeve. Organizatat në fushën e shëndetësisë shprehen që buxheti nuk mbulon nevojat reale si dhe kohëzgjatja e projekteve të mbështetura nga MSH është shumë e shkurtër duke mos siguruar qëndrueshmërinë e programeve dhe shërbimeve.


Kohëzgjatja e shkurtër e thirrjeve të publikuara dhe zbrazëtitë kohore mes thirrjeve për subvencionim, shkaktojnë vështirësi në funksionimin organizatave në fushën e shëndetësisë. KOMF konsideron që forma më e duhur dhe më e qëndrueshme e financimit është përmes blerjes së shërbimeve dhe jo përmes subvencionimit. Kohëzgjatja e projekteve përmes blerjes së shërbimeve duhet të jetë tre vjeçare, për të siguruar kështu funksionim të qëndrueshëm të programeve dhe shërbimeve.

Po ashtu thirrjet nuk janë të bazuara në nevojat reale, duke qenë se Ministria e Shëndetësisë dhe as komunat nuk kanë bërë një vlerësim paraprak të nevojave dhe prioriteteve për ndërhyrje.



## REKOMANDIME:

- +** Krijimi i një skeme të qëndrueshme nga Ministria e Shëndetësisë dhe komunat për kontraktimin/blerjen e shërbimeve nga sektori jo qeveritar dhe privat.
- +** Ministria e Shëndetësisë dhe komunat duhet të rrisin pragun e minimumit të financimit për shërbimet dhe programet e kontraktuara nga sektori jo qeveritar në mënyrë që zbatimi i programeve të jetë efektiv.
- +** Kontraktimi duhet të bëhet në emër të blerjes së shërbimeve në mënyrë që të sigurohet financim i qëndrueshëm dhe afatgjatë. Ofrimi i mbështetjes përmes subvencioneve nuk është i qëndrueshëm dhe nuk konsiderohet si forma më e përshtatshme e financimit të shërbimeve të sektorit jo qeveritar.
- +** Thirrjet për financimin e shërbimeve dhe programeve, duhet të shpallen në periudha tre vjeçare, në mënyrë që të eliminohen zbrazëtitë kohore të krijuara mes thirrjeve.
- +** Ministria e Shëndetësisë dhe komunat duhet të bëjnë vlerësim të nevojave dhe prioriteteve për ndërhyrje para shpalljeve të thirrjeve për blerjen e shërbimeve nga sektori jo qeveritar.
- +** Ministria e Shëndetësisë dhe komunat duhet të lidhin kontrata me organizatat jo qeveritare të dëshmuara me përvojën dhe profesionalizimin e tyre në ofrimin dhe zhvillimin e shërbimeve dhe programeve shëndetësore.  
Shënim: Në kuadër të thirrjeve publike për financim, organizatat ofruese të shërbimeve direkte duhet të jenë të licencuara. Licencimi nuk duhet të jetë kusht për organizatat të cilat ofrojnë programe për edukim shëndetësor, avokim, monitorim, vetëdijesim dhe ngritje të kapaciteteve.





## **Organizatrat anëtare të KOMF:**

Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë – AMC, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti, Nevo Koncepti, Qendra Labyrinth, Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN), Down Syndrome Kosova, Shoqata Autizmi Prishtinë, Handikos Gjakovë dhe Handikos Ferizaj.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Rr. Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3 No.16, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 220 287

Email: [Info@komfkosova.org](mailto:Info@komfkosova.org)





